



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 287/3 prot.

Tiranë, më 15. 05. 2023

**V E N D I M**

**Nr. 71, datë 15. 05. 2023**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, mori në shqyrtim ankesën nr. 27 Regj., datë 20.02.2023, që i përket ankueses L. L.<sup>2</sup>, kundër Bashkisë Fier, me pretendimin diskriminimin për shkak të gjendjes ekonomike dhe civile (si kryefamiljare).

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Ankuesja, L. L., është mbështetur nga Shoqata “Afrohuni, me Ju dhe për Ju”, për paraqitjen e ankesës së saj pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Sipas përfaqësueses së Shoqatës “Afrohuni, me Ju dhe për Ju”, L. L. jeton në kushte ekstreme varfërie, në një banesë të amortizuar në fshatin Afrim i ri, të Bashkisë Fier. Ajo është kryefamiljare dhe jeton me djalin e saj, i cili është person me aftësi të kufizuara.

Përfaqësuesja e Shoqatës “Afrohuni, me Ju dhe për Ju”, S. G., thekson faktin se pasi është njohur me situatën në të cilën ndodhej L. L., ka marrë takim me përfaqësues të Bashkisë Fier, duke kërkuar mbështetje për këtë familje. Sipas saj, Bashkia Fier, e ka informuar se do të merren masa për strehimin e familjes L. dhe do t’i ofrohen të gjitha ndihmat ushqimore që ata disponojnë.

Në vijim, Bashkia Fier i ka ofruar L. L. një bonus qiraje dhe ndihma ushqimore. Pavarësisht këtij fakti, S. G. thekson se bonusi i qirasë prej 10.000 lekë, caktuar nga ana e bashkisë, është i pamjaftueshëm për të gjetur një banesë me qira, pasi 15 % e vlerës taksohet dhe mbeten 8.500 lekë. S. G., sqaron se është interesuar edhe pranë agjencive imobiliare në qytetin e Fierit, për të gjetur një banesë me qira në vlerën e caktuar nga ana e Bashkisë Fier, por nuk ka gjetur zgjidhje.

<sup>1</sup> Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

<sup>2</sup> Përfaqësuar tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga znj. S. G., drejtuese e Shoqatës “Afrohuni, me Ju dhe për Ju”.

Në përfundim, L. L. ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për strehimin e saj, nga ana e Bashkisë Fier.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>3</sup>, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010, i ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 287/1 prot., datë 28.02.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime Bashkisë Fier, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

Nëpërmjet shkresës<sup>4</sup> me nr. 1877/1 prot., datë 09.03.2023, Bashkia Fier, ka dërguar parashtrimet lidhur me informacionin e kërkuar nga Komisioneri, si dhe ka referuar ndër të tjera, se:

<sup>3</sup>Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

<sup>4</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 287/2 prot., datë 13.03.2023

*“...Bashkia Fier, si njësi e vetëqeverisjes vendore, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, gëzon kompetencat ligjore dhe ushtron funksionet administrativo ligjore në fushën e shërbimeve sociale, duke u kujdesur për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore, krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Duke u ndalur në kërkesat e L. L., sqarojmë:*

*Përsa i takon sëmundjes së djalit të saj, është rekomanduar nga punonjësi social i Njësisë Administrative ti drejtohet institucioneve mjeksore për plotësimin e dokumentacionit mjeksor e më pas, dërgimin në KMCAP. Por deri tani nuk ka ardhur asnjë njoftim për këtë qëllim. Qartësojmë se është KMCAP-i ai që merr vendim. Ne bëjmë vetëm pagesën sipas këtij vendimi, brenda kuadrit ligjor përcaktues.*

*Gjithashtu, pranë Bashkisë nuk ka asnjë kërkesë të L. L. për punësim. Por theksojmë se është Drejtoria Rajonale e Punësimit Fier, institucioni që mbulon këtë fushë. Duhet ti drejtohet kësaj drejtorie për të bërë të mundur punësimin e saj, sipas aftësive dhe mundësive.*

*Kriteret për përfitimin e pensionit social përcaktohen nga ISSH-ja, dhe jo Bashkia. Zonja në fjalë trajtohet si familje nga Bashkia me pagesë ndihme ekonomike. Theksojmë se sa herë ka patur shpërndarje ndihmash ushqimore, etj., është parë me përparësi dhe është trajtuar gjithmonë.*

*Përsa i përket kërkesës lidhur me sigurimin e banesës sociale, sjellim në vëmendje se Bashkia Fier, menjëherë pas njohjes me rastin, ka vënë në dispozicion të gjithë asistencën dhe informacionin e nevojshëm mbi dokumentacionin dhe procedurat administrativo-ligjore për përfshirjen në programet sociale të strehimit konform parashikimeve ligjore të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social” dhe akteve ligjore në zbatim të tij, konkretisht VKM nr. 385, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe afateve e procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”.*

*Më datë 19.09.2022 është depozituar pranë Sportelit të Drejtorisë Juridike, Zyra e Shërbimit me Një Ndalesë Formulari TIP “Kërkesë për tu trajtuar me strehim”.*

*Në vijim, menjëherë ka filluar procedura administrativo-ligjore për trajtimin e rastit të L. L., dhe aktualisht Bashkia Fier ka kryer procesin e verifikimit të kushteve të banimit dhe banesës, si dhe ka kërkuar informacion pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier nëse figurojnë pasuri të paluajtshme në emrin e saj, kriteret ligjore të cilat janë thelbësore për të përcaktuar ecurinë e mëtejshme të kërkesës për strehim.*

*Në përfundim të të gjithë procedurave kjo shtetase me Vendim të Këshillit Bashkiak, është trajtuar me programin e bonusit të qirasë. Nuk ka arritur të depozitojë kontratë qiraje brenda afateve ligjore, por Bashkia, për ti ardhur në ndihmë, e ka ripërfshirë këtë shtetase edhe në listën e familjeve përfituese për tu trajtuar me këtë program, listë e miratuar në Janar 2023 me vendim të Këshillit Bashkiak. Afati përfundimtar i depozitimit të qirasë është data 31 Mars 2023.*

*Sqarojmë se përcaktimi i vlerës/masës së subvencionit që përfiton një familje, përcaktohet sipas kriterëve ligjore, të përcaktuara në ligjin nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin*

*social”, VKM Nr. 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKM Nr. 459, datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, bazuar në dokumentacionin administrativo-ligjor të dosjes së familjes aplikuese/përfituese.*

*Masa e subvencionit të qirasë është në varësi të të ardhurave të familjes. Për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituruar atë, masa e subvencionit të qirasë mund të jetë deri në 100% të vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë të njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë përcaktohet çdo vit bazuar në të dhënat e vitit të mëparshëm dhe është miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë Fier, nr. 110, datë 30.11.2022. Sipas nenit 2 pika 36, të ligjit nr. 22/2018, datë 3.5.2018, “Qira mesatare” është mesatarja e ofertave të qirave, të marra gjatë një viti, në tregun e lirë. Qira reale, është vlera aktuale e çmimit të qirasë së një banese të caktuar në tregun e lirë.*

*Duke përfunduar, ju sjellim në vëmendje që Bashkia Fier dhe strukturat përgjegjëse të saj, janë plotësisht të angazhuara dhe të predispozuara për ti mundësuar të gjithë qytetarëve/banorë të juridiksionit të saj territorial, të gjithë ndihmën dhe asistencën e nevojshme në garantimin e të drejtës themelore të strehimit të përshtatshëm dhe të përballeshëm, konform dispozitave ligjore në fuqi, si dhe të gjithë ndihmën dhe asistencën e nevojshme për zbutjen e situatës ekonomiko-financiare përmes adaptimit apo përfshirjes në programet e punësimit, por edhe përmes ndihmave ushqimore, veshmbathje, higjenesanitare, etj.”.*

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm**

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankueses, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet se: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”*.

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b<sup>5</sup>, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;

---

<sup>5</sup> Neni 20/1/a dhe b, të ligjit nr. 10221/2010: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...”*

- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e saj për të përfituar të mira apo shërbime nga ana e Bashkisë Fier dhe më konkretisht në lidhje me strehimin e saj.

*Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:*

Subjekti ankues, L. L., është mbështetur nga Shoqata “Afrohuni, me Ju dhe për Ju”, për paraqitjen e ankesës së saj pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga palët në proces, L. L. jeton në kushte varfërie, në një banesë të amortizuar në fshatin Afrim i ri, të Bashkisë Fier. Ankuesja është kryefamiljare dhe jeton me djalin e saj, i cili rezulton se është diagnostikuar si person me aftësi të kufizuara.

Referuar pretendimeve të ngritura në ankesë dhe informacionit të përcjellë, Bashkia Fier i ka ofruar L. L. një bonus qiraje dhe ndihma ushqimore. Pavarësisht këtij fakti, S. G. ka pretenduar se bonusi i qirasë prej 10.000 lekë, caktuar nga ana e bashkisë, është i pamjaftueshëm për të gjetur një banesë me qira. S. G., sqaron se është interesuar edhe pranë agjencive imobiliare në qytetin e Fierit, për të gjetur një banesë me qira në vlerën e caktuar nga ana e Bashkisë Fier, por nuk ka gjetur zgjidhje.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimit të subjektit ankues, Komisioneri ka analizuar aktet ligjore e nënligjore, të cilat përcaktojnë procedurat për subvencionimin e qirasë me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim.

Ligji nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, në nenin 2, pika 1 e tij parashikon se: *“Aftësi paguese” është tërësia e mjeteve financiare që një familje mund të përdorë për pagesën e qirave ose të kësteve të kredive, në raport me të ardhurat familjare, në masën e përcaktuar në këtë ligj*”. Ndërsa në pikën 29, të këtij neni përcaktohet se: *“Programe sociale strehimi” janë programe që shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve që nuk kanë banesë dhe banojnë në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim apo në një banesë të përkohshme, në kuptim të këtij ligji, që nuk kanë mundësi ekonomike e financiare për të siguruar një banesë, si dhe ato familje/individë, banesa e të cilëve është nën normën ligjore të strehimit dhe që nuk kanë të ardhura që të sigurojnë pagesën për një qira minimale në tregun e lirë”*.

Në nenin 13<sup>6</sup>, të tij Ligji nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, përcakton se:

<sup>6</sup> Kushtet për fitimin e statusit të përfituesit nga programet sociale të strehimit.

“1. Statusin e përfituesit nga programet sociale, sipas këtij ligji, e gëzon çdo individ që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët në momentin e aplikimit plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) nuk kanë në pronësi një banesë ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit apo banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi, për të cilat normat e strehimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat:

i) i fatkeqësive natyrore;

ii) i prishjes së objekteve të pakualifikuara si banesë;

iii) i zhvendosjeve për shkak të investimeve publike dhe nga objektet e përjashtuara nga procesi i legalizimeve;

iv) nga zbatimi i akteve administrative dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë;

c) familjet që kanë një banesë të vjetër, në rrezik shembjeje, ose një banesë që i nënshtrohet një plani rregullues, për shkak të vjetërsisë së saj.

2. Përfitojnë nga programet e strehimit social të këtij ligji edhe shtetas të huaj, me qëndrim të rregullt në Shqipëri dhe që kanë përfituar nga organet kompetente statusin si “punëtor emigrant” dhe/ose “azilkërkues”.

3. Parashikimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen vetëm për ato individë/familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji...”.

Neni 14, i ligjit të sipërcituar, referon rregullat e përgjithshme për aplikimin në programet sociale të strehimit, ku përcaktohet se: “

1. Përfshirja në programet sociale të strehimit bëhet nëpërmjet aplikimit në zyrën përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore të vendbanimit/ vendqëndrimit të aplikantit.

2. Individit/familja pa të ardhura, me të ardhura shumë të ulëta ose të ulëta, që aplikon, paraqet vetëm kërkesën për programin social të strehimit, sipas formatit të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Njësia e vetëqeverisjes vendore plotëson dosjen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, i cili sigurohet me shpenzimet e vetë njësisë së vetëqeverisjes vendore për këta aplikantë.

3. Dokumentacioni për të përfituar strehim, sipas çdo programi, afatet dhe procedurat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Neni 16, përcakton “Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve”, ku referohet se:

“Njësia e vetëqeverisjes vendore, në përzgjedhjen e individëve/familjeve përfituese, për hartimin dhe miratimin e sistemit të pikëzimit bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) Kushtet e strehimit, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:

i) nuk disponojnë banesë në pronësi;

ii) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje;

iii) banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;

iv) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore;

v) familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor;

vi) banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.

b) Kushtet familjare, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:

i) familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;

ii) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;

iii) familjet me më shumë se katër fëmijë;

iv) bashkëshortët, moshën e përgjithshme e përbashkët e të cilëve arrijnë deri në 60 vjeç....

ç) Kushtet ekonomike, në bazë të të cilave përcaktohen familjet, sipas grupeve të të ardhurave, të përcaktuara në këtë ligj...”.

Neni 38, pika 1 e ligjit nr. 22/2018, përcakton se: “1. Vlera e subvencionit të qirasë mund të jetë deri në 100 për qind e vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë për njësinë e vetëqeverisjes vendore ku jepet ky subvencion. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë përcaktohet çdo vit, bazuar në të dhënat e vitit të mëparshëm, dhe miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore”.

Referuar informacionit të administruar nga palët në proces, familja e ankueses jeton në kushte të vështira ekonomike, në një banesë që rrezikon shembjen dhe për këto arsye trajtohet nga ana e Bashkisë Fier me ndihmë ekonomike si familje në nevojë.

Lidhur me aktet nënligjore të nxjerra sa i përket kritereve dhe dokumentacionit për përfitimin nga programet e strehimit social, Komisioneri vëren se:

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, parashikon se: “... ”

4. Aplikimi për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit, me përjashtim të rasteve të nevojës emergjente për strehim, bëhet me dy faza. Në fazën e parë aplikantët paraqesin kërkesën e tyre për të përfituar nga programet e strehimit social, sipas ligjit nr. 22/2018. Në fazën e dytë të aplikimit përfshihen vetëm ata/o individë/familje që janë përzgjedhur për t'u trajtuar me njërin prej programeve të strehimit.

5. Individit/familja paraqet kërkesën për të përfituar nga programet e strehimit social në çdo kohë, sipas formatit të miratuar nga këshilli bashkiak, bazuar në modelin që i bashkëlidhet këtij vendimi, si shtojca “A” dhe sipas deklaratimit tip për vërtetësinë e të dhënave që i bashkëlidhet këtij vendimi, si shtojca “B”. Për paraqitjen e kërkesave verbale, struktura përgjegjëse për strehimin mund të caktojë një orar të posaçëm brenda orarit zyrtar të punës së njësisë së vetëqeverisjes vendore. Ky orar bëhet publik edhe në faqen e internetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

6. Aplikimi paraqitet drejtpërdrejt në strukturën përgjegjëse për strehimin të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose në zyrën e qëndrimit me një ndalesë të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në rast se ka një të tillë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të vendosin që kërkesa të tilla të paraqiten pranë njësisë administrative më të afërta me qendrën e banimit të personave

*që paraqesin kërkesën, duke përcaktuar edhe kompetencat e tyre në përputhje me legjislacionin për vetëqeverisjen vendore. Personat që ekzekutojnë dënimin penal me burgim mund ta paraqesin kërkesën pranë institucionit ku gjenden të ndaluar ose ku ekzekutojnë dënimin penal me burgim...*

*...18. Struktura përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, menjëherë, por jo më vonë se brenda 3 (tri) ditëve pas hartimit të listës përfundimtare të aplikantëve, ia dërgon atë për miratim këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, i cili e shqyrton atë dhe merr vendim në mbledhjen e radhës...*

Nga informacioni i dhënë nga palët në proces, rezulton se më datë 19.09.2022, ankuesja ka depozituar pranë Zyrës së Shërbimit me Një Ndalesë, Formularin TIP “Kërkesë për tu trajtuar me strehim”. Në vijim, Bashkia Fier ka kryer procesin e verifikimit të kushteve të banimit dhe në përfundim të të gjithë procedurave që parashikon legjislacioni i sipërcituar, me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 2, datë 30.01.2023 “Për miratimin e subvencionimit të qirasë për familjet e pastreha, që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar vetë gjithë vlerën e qirasë”, ankuesja është përfshirë në listën e familjeve që përfitojnë nga subvencionimi i qirasë.

Referuar informacionit të administruar nga palët, ankuesja pavarësisht faktit që ka përfituar nga programet sociale për subvencionimin e qirasë, nuk ka arritur të gjej një banesë me qira dhe të depozitojë një kontratë qiraje, për shkak të çmimeve të banesave në tregun e lirë.

Sa i përket vlerës së subvencionit të qirasë që përfiton një familje, ajo përcaktohet sipas kriterëve ligjore, të përcaktuara në ligjin nr. 22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social” dhe VKM-në Nr. 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”.

Referuar legjislacionit dhe akteve nënligjore të sipërcituara, masa e subvencionit të qirasë është në varësi të të ardhurave të familjes. Për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë, masa e subvencionit të qirasë mund të jetë deri në 100% të vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Sipas parashikimeve ligjore, vlera maksimale e subvencionit të qirasë përcaktohet çdo vit bazuar në të dhënat e vitit të mëparshëm. Gjithashtu, referuar nenit 2 pika 36, të ligjit nr. 22/2018, “Qira mesatare” është mesatarja e ofertave të qirave, të marra gjatë një viti, në tregun e lirë. Qira reale, është vlera aktuale e çmimit të qirasë së një banese të caktuar në tregun e lirë. Për këtë, Bashkia Fier me Vendim të Këshillit Bashkiak Fier, nr. 110, datë 30.11.2022, ka miratuar vlerat mesatare të qirasë për familjet që përfitojnë nga programi i subvencionimit të qirasë, si më poshtë:

- Garsonierë.....6,400 lekë;
- Apartament 1 + 1.....10,000 lekë;
- Apartament 2 + 1.....15,000 lekë;
- Apartament 3 + 1.....18,000 lekë;

Nga analiza e informacionit dhe provave të administruara, me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 2, datë 30.01.2023 *“Për miratimin e subvencionimit të qirasë për familjet e pastreha, që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar vetë gjithë vlerën e qirasë”*, kanë përfituar:

- 7 familje nga programi i subvencionimit të qirasë, në vlerën 6,400 lekë, të cilat në përbërje të tyre kanë patur 1 anëtar;
- 4 familje nga programi i subvencionimit të qirasë, në vlerën 10,000 lekë, të cilat në përbërje të tyre kanë patur 2 anëtarë, ku bën pjesë edhe ankuesja;
- 1 familje nga programi i subvencionimit të qirasë, në vlerën 10,000 lekë, e cila në përbërje të saj ka patur 3 anëtarë;
- 6 familje nga programi i subvencionimit të qirasë, në vlerën 15,000 lekë, të cilat në përbërje të tyre kanë patur 3, 4 dhe 5 anëtarë.

Për rrjedhojë, në analizë të sa më sipër, Komisioneri gjykon se, nga ana e Bashkisë Fier nuk ka patur veprime të padrejta, të pafavorshme apo të paligjshme kundrejt ankueses, përse ajo ka pretenduar. Nga analiza e akteve të sipërcituara dhe provave të administruara, Bashkia dhe Këshilli Bashkiak Fier kanë marrë masat dhe kanë bërë pjesë të listës së familjeve për subvencionimin e qirasë ankuesen në zbatim të legjislacionit të sipërcituar.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përrjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”*

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

*“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:*

*a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për*

*shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*

*b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Fier.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri, arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Fier, kundrejt ankuses, për shkaqet e pretenduara prej saj.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, L. L., për shkak të gjendjes ekonomike dhe gjendjes civile, nga ana e Bashkisë Fier, në fushën e të mirave dhe shërbimeve.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Gjendja ekonomike dhe civile)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)